

NATIONS

on Mission
in Kosovo

PROVISIONAL



NATIONS UNIES
Mission d'Administration
Intérimaire des Nations Unies
au Kosovo

INSTITUTIONS

OF SELF GOVERNMENT

KUVENDI I KOSOVËS
СКУПШТИНА КОСОВА
ASSEMBLY OF KOSOVO

Seanca Plenare
Seanca nr.2003/17
Prishtinë,më 29 maj 2003,në orën 10:00
Ndërtesa e Kuvendit,salla plenare.

PROCESVERBAL

Seancën e kryesoi Nexhat **DACI**, kryetar i Kuvendit, kurse bashkëkryesues ishte Bajram Kosumi,anëtar i Kryesisë.
Kryesusi konstatoi se në seancë ishin të pranishëm 99 deputetë dhe shpalli të hapur punën e saj.

Në seancën e mëparshme ishte miratuar rendi i ditës i kësaj seance,si vijon:

1. Miratimi i procesverbalit të seancës së mëparshme;
2. Shqyrtimi i dytë i P/ligjit për rrugët-3003/7;
3. Shqyrtimi i parë i P/ligjit për prokurim publik në Kosovë-2003/13;
4. Shqyrtimi i parë i P/ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për themelimin e Regjistrimit të të drejtave në pronësinë e paluajtshme-2003/14;
5. Parashtrimi i pyetjeve dhe
6. Propozimi i rendit të ditës për Seancën e ardhshme Plenare që duhet të mbahet më 5 qershor 2003.

Kryesuesi kërkoi nga deputetët e Kuvendit të procedohet sipas rendit të ditës të miratuar në seancën e mëparshme.

Nafye Gas kërkoi sqarime për mosrealizimin e vendimit të Kuvendit të Kosovës në vlerë prej 5 milion Eurosh që i kishte ndarë komunës së Gjilanit për sanimin e pasojave të tërmetit që e kishte goditur këtë komunë vitin e kaluar.

Kryesuesi tha se duhet të kërkohet me këmbëngulësi nga organet kompetente që ta realizojnë vendimin e Kuvendit të Kosovës.

1. Miratimi i procesverbalit të seancës së mëparshme.

Nuk pati vërejtje lidhur me procesverbalin e seancës së mëparshme dhe ai u miratua.

2. Shqyrtimi i dytë i P/ligjit për rrugët-2003/7.

Kryesuesi i vuri në votim amendamentet e Komisionit për Transport dhe Telekomunikacion,të përkrahur nga Komisioni për Buxhet,nga Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe nga Komisioni për Çështje Gjyqësore,Legjislacion dhe Kornizë Kushtetuese,një nga një në këtë P/ligj,të radhituara nga departamenti ligjor.

Kuvendi i miratoi amendamentet:1,2,3,4,5,7a,8,9,10,11,12,13,14,15,16,17,18a,19,20 dhe 21a,kurse i refuzoi amendamentet:6,7b,18b dhe 21b.

Kryesuesi e vuri në votim P/ligjin në tërësi dhe rezultati ishte si vijon;

Për----- 85,
Kundër----0,
Abstenime-0.

Kryesuesi konstatoi:Kuvendi i Kosovës e miratoi Ligjin për rrugët-nr.2003/7.

3. Shqyrtimi i parë i P/ligjit për prokurim publik në Kosovë,nr.2003/13.

Kryesuesi e ftoi ministrin e Shërbimeve Publike që të arsyetonte këtë P/ligj.

Ministri Jakup Krasniqi: Ky ligj ofron zgjidhje sistemore për konsolidimin , racionalizimin dhe përparimin e rregullativës ligjore të prokurimit publik në Kosovë përmes të cilit sigurohet një bazë unike ligjore për ushtimin e aktiviteteve prokuruese të

njësive të sektorit publik , si dhe të ndërmarrjeve që kanë të drejta të veçanta dhe skzekutive për ofrimin e shërbimeve publike në Kosovë.

Qëllimi i nxjerrjes së këtij ligji, në fazën e tanishë të zhvillimit në Kosovë, është sigurimi i përdorimit sa më efikas , transparent dhe josidskriminues i mjeteve buxhetore dhe i fondeve të ndërmarrjeve të tjera publike që janë të një rëndësie të veçantë për Kosovën.Prokurimi publik deri më tani në Kosovë është kryer në bazë të disa akteve legislative të UNMIK-ut , të cilat kanë qenë të paramenduara të jenë të një karakteri të përkohshëm.Andaj , është paraqitur nevoja e ngutshme nxjerrjes së një ligji gjithpërfishrës dhe të hollësishëm për shfrytëzimin e mjeteve buxhetore dhe fondeve tjera me karakter pulbik në Kosovë.

Përmes këtij ligji themelohen rregullat dhe metodat e veçanta të prokurimit publik të cilat autoritetet kontraktuese dhe orperatorët e shërbimeve publike i përdorin për dhënien e kontratave publike.

Ky ligj, objekt trajtimi ka rregullimin e aktiviteteve të prokurimit të mallrave, ushtrimit të aktiviteteve të prokurimit; nxitja e pjesëmarrjës së operatorëve ekonomik në aktivitetet e prokurimit publik; nxitja e konkurrencës në prokurim në mes operatorëve ekonomik për prokurimin e mallrave,të shërbimeve dhe të punëve; sigurimi i trajtimit të barabartë të operatorëve ekonomik gjatë aktiviteteve të prokurimit .

Struktura e këtij P/ligji ishte e radhitur në nëtë kapituj përmes së cilëve normohet kjo materie .

Në fund ministri Jakup Krasniqi i ftoi deputetët e Kuvendit që ta miratonin këtë P/ligj.

Opinionet, vërejtjet dhe sugjerimet e veta në këtë p/ligj i dhanë edhe deputetët: Nerxhivane Dauti, Fatmir Sejdiu, Ibush Jonuzi, Bujar Dugolli dhe Arsim Bajrami, që i janë bashkangjitur stenogramit.

Kryesuesi e vuri në votim këtë p/ligj dhe rezultati ishte si vijon:

Për-----shumica,
Kundër-----asnjë ,
Abstenime-----12 .

Kryesuesi konstatoi:Kuvendi i Kosovës e miratoi në parim P/ligjin për prokurimin publik në Kosovë-nr.2003/13.

4. Shqyrtimi i parë i P/ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për themelimin e Regjistrit të të drejtave në pronësinë e paluajtshme,nr.2003/14.

Kryesuesi e ftoi ministrin e Shqrbimeve Publike që të arsyetonte këtë P/ligj.

Ministri Jakup Krasniqi: Kuvendi i Kosovës me 17 tetor 2002 e ka miratuar Ligjin për themelimin e regjistrit të të drjetave në pronën e paluajtshme . PSSP-ja e ka bërë shpalljen e këtij duke e kushtëzuar këtë me miratimin e amendamenteve plotësuese me të

cilat parashihet njoftimi i vëtrtet publik dhe masat tjera për mbrojtjen e personave , të drejtat e të cilave mund të ndikojnë në këtë regjistër.

Ministria e Shërbimeve Publike është pajtuar në tërësi me sugjerimet e PSSP-së .

Në këtë p/ligj propozohet që pikat 3.3 a) , b), dhe c) të shtohen pas paragrafit 3.3 të cilat kanë të bëjnë me ndryshimin e zyrave komunale kadastrale për vendosjen e tabelës për shpalljen publike me të cilën do t'ju mundësohet të gjithë personave që mendojnë se me

një regjistrim të tillë janë privuar nga ndonjë drejtë lidhur me regjistrimin e të drejtave për pronën e paluajtshme .

Me këto ndryshime përcaktohet edhe mënyra e vendosjes së tabelës dhe mënyra e përdorimit të sajë .

Në nenin 3.3 pika b) është përcaktuar afati optimal pesë ditë pune për afishim të njoftimit pas të cilës kohë zyra komunale kadastrale mund ta marr vendimin defenitiv lidhur me regjistrimin e të drejtave mbi pronën e paluajtshme.

Në nenin 3.3 pika c) parashihet obligimi i zyrave komunale kadastrale që të bëjnë vërtetimin dhe shqyrtimin e rasteve të regjistrimit të banesave pranë Drejtorisë dhe Komisionit për kërkesa pronsorejuridike.

Në fund ministri Krasniqi i ftoi deputetët e Kuvendit që ta miratonin këtë P/ligj .

Opinionet,vërejtjet dhe sugjerimet e veta në këtë p/ligj i dhanë deputetët: Fatmir Sejdiu, Arsim Bajrami, Gojko Saviq, Oliver Jovanoviq , Hydajet Hyseni dhe Ramadan Kelmendi, që i janë bashkangjitur stenogramit.

Kryesuesi e vuri në votim këtë p/ligj dhe rezultati ishte si vijon:

Për-----shumica,
Kundër----- 11 ,
Abstenime----- 1 .

Kryesuesi konstatoi:Kuvendi i Kosovës e miratoi në parim P/ligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për themelimin e Regjistrit të të drejtave në pronësinë e paluajtshme.

5. Parashtrimi i pyetjeve.

Kryesuesi konstatoi se nuk kishte asnjë përgjigje për këtë seancë,në pyetjet e deputetëve.

6. Propozimi i rendit të ditës për seancën e ardhshme plenare.

Kryesuesi propozoi rendin e ditës për seancën e ardhshme plenare që duhet të mbahet më 5 qershor 2003,si vijon:

1. Shqyrtimi i parë i P/ligjit planifikim hapësinor,nr.2003/15;
2. Shqyrtimi i parë i P/ligjit për skemën e ndihmës sociale,nr.2003/26.

Alush Gashi propozoi që Kryesia e Kuvendit,në njëren nga seancat e ardhshme të radhisë shqyrtimin e çështjes së privatizimit,me ç'rast duhet të ftohen:AKM-ja dhe institucione të tjera kompetente të kësaj fushe.

Kuvendi e miratoi rendin e ditës për seancën e ardhshme plenare,si dhe propozimin e deputetit Alush Gashi.

Seanca përfundoi në orën 12:30 minuta.

Sekretaria e Kuvendit

Kryetari i Kuvendit të Kosovës,

akademik Nexhat DACI